



KËRKESË PËR OFERTË

Data: 14 nëntor 2022

Nr. i protokollit: 582/2022

Titulli i lëndës: Furnizim me uniforma shkollore për nxënësit

SHFMU “Naim Frashëri”, Prishtinë, fton të gjithë operatorët ekonomik të interesuar që t’i përgjigjen kërkesës për ofertë “Furnizim me uniforma shkollore për nxënësit”.

Kërkesat e keshillit drejtues të shkollës për uniforma janë si në vijim:

BLUZË ME MËNGË TË SHKURTËR	BLUZË MË MËNGË TË GJATË	XHUP (DUKS) ME ZINXHIR (PATENT) ME KAPELE
		
Ngjyra e kaltër, jaka dhe mëngët me shirit me ngjyra të kuqe dhe të gjelbër	Ngjyra e kaltër, jaka dhe mëngët me shirit me ngjyra të kuqe dhe të gjelbër	Ngjyra e kaltër, shiriti tek duart dhe fundi me ngjyra të kuqe dhe të gjelbër

Vërejtje: fotot e prezantuara janë përdorur vetëm si model (tabela 1.1)

Specifikat Teknike:

1. Bluzat me mëngë të shkurtra duhet të jenë me jakë dhe pulla me ngjyrë të kaltër;
2. Bluzat me mëngë të gjata duhet të jenë me jakë dhe pulla me ngjyrë të kaltër;
3. Xhupi (Duksi) të jetë me zinxhir (patent) me kapelë;
4. Ngjyra e kaltër e qiellit (pigment i mesëm);
5. Jaka dhe shiriti rreth mëngëve duhet të ketë dy vija, një ngjyrë të kuqe dhe një të gjelbër
6. Të gjitha produktet duhet të kenë logon e shkollës në krahun e majtë me qepje
7. Të gjitha produktet duhet të jenë të kualitetit të lartë të mos dëmtohen nga larja e shpeshtë dhe të përmbajnë së paku 80% pambuk
8. Kualiteti i materialeve të jetë i garantuar për së paku një (1) vit
9. Furnitori duhet të siguroj që prindërit do të mund të furnizohen direkt sa herë që kanë nevojë për uniformë në një periudhë prej 15 ditësh prej marrjes së masës trupore dhe porosisë nga nxënësi apo prindi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Shkolla Fillore e Mesme e Ulët
“NAIM FRASHËRI”, Prishtinë

10. Blerësi mban të drejtën e reklamimit të produktit brenda 48 orëve dhe ajo duhet të ndërrohet nga furnitori.
11. Kontrata do të jetë një vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për dy vite shtesë, varësisht nga performanca e furnitorit dhe çmimet e tregut.
12. Numri total i nxënësve në shkollën tonë është 1 029 të ndarë në 39 paralele.
13. Çdo furnitor duhet të ofroj **SË PAKU** nga një set të uniformës falas/gratis për secilën paralele.

Kriteret e shpërblimit do të jenë bazuara në ofertën ekonomisht më të favorshme si në vijim:

1. Çmimi më i lirë 60%
2. Kualiteti 30%
3. Sasia e ofruar e uniformave falas/gratis 10%

Ofertë e përgjegjshme (valide) do të konsiderohet ajo që përmban të gjithë elementet si në vijim:

#	Kërkesat e përshtatshme:	Dëshmia
1	Oferta financiare valide për 90 ditë	Oferta financiare
1.1.	Çmimi për bluzë me mëngë të shkurtra	Oferta financiare
1.2.	Çmimi për bluzë me mëngë të gjata	Oferta financiare
1.3.	Çmimi për xhup (duks)	Oferta financiare
2	Numri i uniformave falas/gratis	Të jetë e përfshirë në ofertën financiare
3	Biznesi duhet të jetë i regjistruar në Kosovë	Certifikata e regjistrimit të Biznesit
4	Biznesi duhet të jetë i regjistruar në ATK	Vërtetimi tatimor me numër fiskal
5	Dëshmia e pronësisë	Kopje e letërnjoftimit të pronarit ofertues
6	Të posedoj llogari bankare për pagesa të porosive	Shënimet e llogarisë bankare
7	Dëshmi që nuk janë të përfshirë në aktivitete ilegale	Vërtetimi nga gjykata themelore që pronari/menaxhmenti nuk janë të dënuar apo nën hetime për vepër penale
8	Dëshmi që biznesi nuk është në procedurë të falimentimit	Vërtetimi nga gjykata ekonomike që biznesi nuk është në procedurë të falimentimit
9	Dëshmi mbi kualitetin e materialit	Certifikata e kualitetit të materialit
10	Gatishmëria të furnizoj për periudhën një deri në tre vite	Deklaratë e zotimit e nënshkruar dhe vulosur nga biznesi
11	Mostra e uniformës	Një set i plotë i uniformës

1.2. Tabela e përshtatshme

Konkursi do të mbetet i hapur për shtatë (7) ditë pune nga data e shpalljes, respektivisht deri më 23 nëntor 2022.

Operatorët ekonomik të interesuar duhet t'i dorëzojnë ofertat e tyre së bashku me mostrat e uniformave të kërkuara, në drejtorinë e SHFMU “Naim Frashëri, të (dita e javës), me 23 nëntor 2022 nga ora **14:00 deri në 15:00**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Shkolla Fillore e Mesme e Ulët
“NAIM FRASHËRI”, Prishtinë

Të gjitha ofertat duhet të jenë me pliko/zarf të mbyllur dhe vulosur në pjesën e mbylljes. Ofertat të cilat nuk janë mbyllura dhe vulosura do të refuzohen nga Drejtoria dhe Komisioni për vlerësimin e ofertave. Ofertat elektronike nuk pranohen!

Ofertat e mbyllura do të dorëzohen nga drejtoria tek Komisioni për hapjen e ofertave në ora 16:00. Ofertat e pranuar **do të hapen po të njëjtën datë** nga Komisioni për vlerësimin e ofertave **nga ora 16:00 – 17:00** në sallën e Bibliotekës së Shkollës, në prani të ofertueseve dhe të të gjithë të interesuarve të tjerë.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të përzgjedhin ofertën më të favorshme për nga aspekti ekonomik dhe kualitativ, andaj ju inkurajojmë të dorëzoni ofertat në përshtatshmëri me kushtet e nxënësve dhe prindërve tanë. Komisioni mban të drejtën të kontaktoj ofertuesin për informata shtesë apo sqarime lidhur me ofertën e dorëzuar/pranuar, me interes të arritjes deri tek një kontratë sa më e favorshme.

Komisioni mban të drejtën të refuzoj të gjitha ofertat nëse ato vlerësohen si të pa favorshme. Komisioni për vlerësimin e ofertave do të përbehet nga përfaqësues të këshillit të prindërve, këshillit të nxënësve, këshilli drejtues i shkollës dhe menxhmenti i shkollës do të vlerësojnë ofertat dhe do të përzgjedhin ofertën më të volitshme për prindër.

Rezultati final i vlerësimit do të bëhet jo më vonë se dy (2) ditë pas hapjes së ofertave, respektivisht me **25 nëntor 2022**, përmes postës elektronike dhe njoftimit në hapësirë publike. Rezultati bashkëngjitur me arsyetimet e vlerësimit do të publikohet për secilën ofertë të pranuar.

Çdo paqartësi apo pyetje që keni lidhur me këtë kërkesë për ofertë mund ta adresoni në emailin e shkollës: shfnaimfrasheri@hotmail.com.

Kjo kërkesë dhe rezultati i ofertave do të publikohen në hyrje të shkollës, në faqen e Facebook të SHFMU Naim Frashëri, tek tre hyrjet në oborrin e shkollës, tek tabela e njoftimeve të Komunës së Prishtinës, si dhe në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës tek njoftimet.